



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Kom.Dh.Shk.II.nr.1093/2023

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË, Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari individual Dren Rogova, në çështjen përmbare të kreditorit “AYEFLEET” L.L.C, me seli në lagjën Arbëria 3, Veranda C2/7, Hy.1 lok.2A, në Prishtinë, kundër debitorit “Kujtesa Net” SH.P.K., me adrese në rr.“Ukshin Hoti” nr.31, në Prishtinë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Shoqëria e Avokatëve “Sejdiu & Qerkini” SH.P.K., për shkak të borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm KPPP.nr.555/2022 të datës 13.06.2023, me datë 12.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET poshtë si e palejuar ankesa e debitorit “Kujtesa Net” SH.P.K., me seli në Prishtinë, e parashtruar ndaj aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë Departamenti i Përgjithshëm, KPPP.nr.555/2022 të datës 13.06.2023.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.555/2022 të datës 13.06.2023, në pikën I të dispozitivit ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit “Kujtesa Net” SH.P.K., të paraqitur kundër urdhrit përmbare P.nr.1273/20 të datës 21.09.2020, të përmbaresit privat Isa Gacaferi. Në pikën II të dispozitivit ka lënë në fuqi urdhri përmbare P.nr.1273/20 të datës 21.09.2020, të përmbaresit privat Isa Gacaferi.

Kundër aktvendimit të lartcekur brenda afatit ligjor ankesë ka ushtruar i autorizuari i debitorit për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, ndërsa aktvendimi i ankimuar dhe urdhri përmbare të anulohen.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për procedurën përmbare si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

- Ankesa e debitorit është e pasafatshme.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “AYEFLEET” L.L.C, me seli në lagjen Arbëria 3, Veranda C2/7, Hy.1 lok.2A, në Prishtinë, me datë 18.09.2020, ka paraqitur propozim për përmbnim kundër debitorit “Kujtesa Net” SH.P.K., me adrese në rr.“Ukshin Hoti” nr.31, në Prishtinë, në bazë të dokumentit të besueshëm – faturës nr.INV-000570 të dt.01.08.2020, faturës nr.INV-000667 të dt. 01.09.2020, faturës nr.INV-000474 të dt. 01.07.2020, faturës nr.INV-000375 të dt. 01.06.2020, faturës nr.INV-000285 të dt. 01.05.2020, faturës nr.INV-000195 të dt. 01.04.2020, faturës nr.INV-000123 të dt. 02.03.2020 dhe faturës nr.INV-000067 të dt. 03.02.2020, për shumën e përgjithshme të borxhit 5,267.36 €.

Përmbnuesi privat Isa Gacaferi, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka caktuar urdhrin P.nr.1273/2020 të datës 21.09.2020, duke lejuar përmbnmin në bazë të dokumentit të besueshëm – faturave, ku e ka urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij urdhri t’ia paguaj borxhin total kreditorit në shumë prej 5,267.36 €, me kamatë ligjore prej 8 %, si dhe shpenzimet e procedurës përmbnimore. Kundër këtij urdhri debitori ka paraqitur prapësim me datë 28.09.2020, duke e kundërshtuar në tërësi urdhrin, me arsyetimin se pretendimi i kreditorit për realizimin e borxhit është i paqëndrueshëm për shkak se shërbimi i ofruar nga kreditori nuk i ka përmbushur kërkesat e debitorit siç palët janë dakorduar në fillim dhe ka pasur mungesa esenciale gjë që ka pamundësuar funksionimin e shërbimit të ofruar. Tutje ka theksuar se faturat nuk i përgjigjen shërbimit të dakorduar nga palët dhe nuk janë të pranuar nga debitori respektivisht nuk kanë tipare të përmbnueshmërise. Andaj, ka propozuar që të aprovohet në tërësi prapësimi si i bazuar, të anulohet urdhri përmbnrimor P.nr.1273/20 i datës 21.09.2020 si dhe të detyrohet kreditori të ja kompensoj shpenzimet procedurale debitorit. Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori me datë 06.10.2020, duke theksuar se në bazë të fakteve të paraqitura në prapësimin e debitorit nuk përmbushen kriteret konform dispozitave të nenit 71 të LPP-së, se asnjë nga pretendimet rreth kualitetit të shërbimeve nuk qëndrojnë pasi që në momentin e pranimit nuk janë kontestuar as fatura e as kualiteti i shërbimeve. Sa i përket pretendimit që debitori nuk i ka pranuar faturat nuk qëndron pasi që debitori i ka pranuar të gjitha faturat përmes postës elektronike zyrtare, ndërsa pakënaqësitë nga shërbimet e dhëna nuk janë fare relevante për këtë procedurë përmbnimore. Andaj, ka propozuar që të refuzohet në tërësi si i pabazë prapësimi, të mbetet në fuqi urdhri përmbnrimor si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbnimore t’i ngarkohen debitorit.

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.555/2022 të datës 13.06.2023, me të cilin në pikën I të dispozitivit ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit “Kujtesa Net” SH.P.K., të paraqitur kundër urdhrin përmbnrimor P.nr.1273/20 të datës 21.09.2020, të përmbnuesit privat Isa Gacaferi. Në pikën II të dispozitivit ka lënë në fuqi urdhri përmbnrimor P.nr.1273/20 i datës 21.09.2020, i përmbnuesit privat Isa Gacaferi., duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, duke vepruar si gjykatë e shkallës së dytë, pas shqyrtimit të ankesës së debitorit dhe shkresave të lëndës, vërtetuan faktin se debitori “Kujtesa.Net”, me seli në Prishtinë, e ka pranuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë në mënyrë të rregullt përmes postës me datë 29.06.2023 – gjë që vërtetohet nga fletkthesa e postës. Ndërkaq, nga ankesa rezulton se e njëjta në postë është dorëzuar me datë 07.07.2023, fakt ky i cili vërtetohet nga vula e pranimit të Postës së Kosovës. Pra, në rastin konkret, evidentohet se ankesa është dorëzuar me datë 07.07.2023, përmes postës – datë kjo kur konsiderohet e parashtruar ankesa.

Sipas vlerësimit të Dhomave të Shkallës së dytë të kësaj Gjykate, pasi që në këtë çështje përmbartimore, sipas Nenit 77 par.2 të LPP afati për ankesë është 7 ditë nga dita e pranimit të aktvendimit të shkallës së parë me të cilin është vendosur lidhur me prapësimin, atëherë rezulton që ankesa është dorëzuar pas skadimit të afatit ligjor prej 7 ditësh. Meqenëse, debitori në adresën zyrtare të selisë e ka pranuar vendimin e atakuar me datë 29.06.2023, ndërsa ankesën e ka paraqitur pas skadimit të afatit ligjor me datë 07.07.2023 – që vërtetohet nga vula e pranimit të dërgesës në postë. Në këtë drejtim rrjedh se ankesa është parashtruar pas skadimit të afatit ligjor prej 7 ditësh. Përkritazi me afatin për parashtrimin e mjetit juridik, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësojnë se afati i paraqitjes së ankesës është prezumim procedural, lëshimi i të cilit ka për pasojë palejueshmërinë e shqyrtimit të ankesës dhe si e tillë ankesa hedhet poshtë pa shqyrtim të mëtejshëm të pretendimeve ankimore.

Në bazë të nenit 186.1 të LPK-së parashihet se ankesa e paraqitur pas afatit të parashikuar me ligj, ankesën jo të plotë, apo ankesën e palejueshme e hedh poshtë me aktvendim gjykata e shkallës së parë pa caktuar fare seancë gjyqësore. Ndërsa në bazë të nenit 186.2 të LPK parashihet se ankesa është e pasafatshme po që se është paraqitur pas skadimit të afatit ligjor. Meqë gjykata e shkallës së parë nuk e ka hedh poshtë si të pasafatshme ankesën e debitorit, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, në bazë të nenit 196 të LPK-së e ka hedhë poshtë ankesën si të palejueshme

Nga të cekurat më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktvendimit dhe atë në bazë të nenit 195.1 pika a), lidhur me nenin 196 të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
Kom.Dh.Shk.II.nr.1093/2023 me datë 12.03.2024

Gjyqtari,
Dren Rogova